

VENDIM
Nr. 260, datë 10.4.2026

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 61, DATË 29.1.2025, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË
PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË
PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT ‘NDËRTIMI I FIDERAVE ME KABËLL
20 kV, V4, V5 DHE KABINAVE TË REJA NGA NËNSTACIONI I RI VALIAS”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të dhënat e pasurisë me numër rendor 8 të tabelës, bashkëlidhur vendimit nr. 61, datë 29.1.2025, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i fiderave me kabëll 20 kV, V4, V5 dhe kabinave të reja nga nënstacioni i ri Valias”, të ndryshuar, zëvendësohen me të dhënat e pasurisë me numrin rendor 8 të tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpenzimet procedurale shtesë, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga buxheti i Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group sh.a.

3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group sh.a., Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Kamzë Vorë, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Tiranë dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR PASURITË E PALUAJTSHME,
PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “NDËRTIMI I FIDERAVE ME KABËLL 20 kV, V4, V5 DHE
KABINAVE TË REJA NGA NËNSTACIONI I RI VALIAS”

Nr.	Nr. i shtyllës	PRONARI			TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)							VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM				SHËNIME (Kufizime hipotekare, barrë mbi pasurinë etj.)
												ARË/TRUALL			VLERA TOTALE (lekë)	
		Emër	Atësia	Mbiemër	Fshati ose qyteti	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)		
8	K15/V4	Armand Denisa	Hamdi Ramazan	Çela Çela	Valias	15/14	380/91	Are	2,761	9	110	24	717	17,208	17,208	